



REPUBLIKË E SHqipërisë  
BASHKIA GRAMSH  
KESHILLI BASHKIAK

KOMISIONI I SHERBIMEVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE STREHIMIT

RAPORT VENDIMARRJE

Nr.1, Datë 29/05/2024

Lënda: Vendim për shqyrtimin e projekt-vendimit nr.....datë,.....05.2024 “Plani Lokal i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane 2024-2029”

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Gramsh

Hyrje

Ky projekt-vendim paraqitet nga Drejtoriae Sherbimit Pyjor, Mjedisit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, dhe ka për qëllim:

BAZUESHMERIA LIGJORE DHE VOTIMI	Hartimi i planit vendor nga Njësitë e Vet-qeverisjes vendore është një detyrim ligjor i përcaktuar nga Ligji i ri nr.10 463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i amenduar, në nenin 12, pika 2 citohet: “Çdo njësi e qeverisjes vendore apo grup njësisish të qeverisjes vendore harton planin vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve për territorin që ka nën juridiksion, në përputhje me planin kombëtar dhe planin rajonal të menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe me kërkesat e nenit 10 të këtij ligji”. Ligji 139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore” datë 17.12.2015, i ndryshuar, Rregullores së Pergjithshme të Këshillit Bashkiak dhe Rregullores së Konsultimit Publik. Ky projekt-vendim bazohet në nenin 54 të ligjit 139/2015, pika “k”. Votimi që kërkohet është me shumicë thjeshte me 50+1
SITUATA AKTUALE E FUNKSIONIT	Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore” dhe ligjin nr.10463 datë 22.09.2011 PLMIMNU është instrumenti kryesor i planifikimit për përcaktimin e vizionit dhe objektivat specifike, të mundshëm nga ana ekonomike dhe mjedisore, në lidhje me drejtimit që do të ndërmarrë bashkia në fushën e menaxhimit të mbetjeve. Këto <u>objektiva specifike</u> reflektojnë orietimet e politikës kombëtare drejt menaxhimit të integruar të mbetjeve, të aktualizuara në gjendjen ekzistuese të bashkisë. Mbi bazën e objektivave specifike të dakordësuar në të gjitha nivelet vendimarrëse dhe me grupet e interesit, plani fillon dhe analizon <u>skenarët</u> e mundshëm të organizimit të

	shërbimit të shoqëruar me <u>koston</u> përkatëse dhe <u>politikën fiskale</u> që duhet të ndjekë bashkia në mbulimin e plotë të koston. PLMIMNU përfundon me një <u>plan veprimi konkret</u> të ndarë në afate kohore, brenda <u>një 5 vjeçari</u> , sipas <u>përgjegjësive përkatëse të aktorëve të përfshirë në zbatimin e planit.</u>
SITUATA FINANCIARE (Impakti financiar, shtesa pakësime në buxhet)	Bazuar në tarifat aktuale të aplikuara nga Bashkia Gramsh në tre zonat e ofrimit të shërbimit – banoret/familjaret aktualisht mbajnë pjesen kryesore të barrës fiskale (nëse ato do të paguajnë të gjithë) dhe pjesën tjetër do të duhet ta mbulojnë konsumatorët e tjerë (biznese dhe institucione) për koston e plotë të skenarit bazë. Në këtë kuadër, propozohet për vitet në vazhdim një rritje tarife prej 10 për qind/vit për banoret/familjaret për të mundësuar mbulimin e koston O&M. Propozohet që bashkia të parashikojë rritjen e tarifës së pastrimit për banoret/familjaret si në tabelën përkatëse në PLMIMNU 2024-2029. Gjithsesi, rritja e tarifave do të jetë objekt konsultimi me komunitetin në muajt shtator-nentor 2024 si pjesë e PBA 2025-2027.
DREJTORIA PËRGJEGJËSE	Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Mjedisit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit
RAPORTIMI DHE MONITORIMI	Raportimi do të realizohet çdo fund viti për zbatimin e Planit dhe paraqitet çdo fund Janari në Këshillin Bashkiak.
IMPAKTI SOCIAL DHE GRUPET QË PREKEN	Plani është shtrirë në zonën urbane - qytetin Gramsh, dhe në zonat rurale - Njesite Administrative Pishaj dhe Kodovjat, dhe planifikohet të shtrihet edhe në njesite e tjera administrative të Bashkisë Gramsh.
KONSULTIMI PUBLIK	Ky projekt vendim kërkon konsultim publik sipas nenit 17 të ligjit 139/2015, dhe të Rregullores së Këshillit. Është marrë vendimi i Kryesise për kalimin në konsultim publik të projektaktit. Është hartuar dhe publikuar në faqen e internetit të Bashkisë Gramsh, njoftimi dhe kalendari për degjasat publike. Megjithatë sipas kalendarit të konsultimeve/degjesave publike të publikuar në afqen e internetit të bashkisë Gramsh, ishin planifikuar dy degjesa, një në qytetin Gramsh dhe një në njesinë administrative Pishaj, në datë 23.05.2024, mungesa e pjesëmarrjes së banorëve solli nevojën e organizimit të një degjese tjetër në datë 27.05.2024, në Qendren e Kultures Thoma Prifti, Gramsh me pjesëmarrje të



BASHKIA GRAMSH



REPUBLIKË E SHqipërisë  
BASHKIA GRAMSH  
KESHILLI BASHKIAK

KOMISIONI I SHERBIMEVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE STREHIMIT

	komunitetit, anetareve të Keshillit Bashkiak dhe administratës së Bashkisë. Bashkelidhur lista e pjesëmarrësve. Është mbajtur mbajtur proces-verbali i takimit dhe kanë dalë rekomandimet për konsultimin publik të cilat janë përmbledhur dhe i janë dërguar Kryetarit të Bashkisë për reflektim.
--	--

Komisioni i Përhershëm i Sherbimeve Publike, Transportit dhe Strehimit, i mbledhur më datën 29.05.2024 pasi shqyrtuan Projekt-vendimin për miratimin e Planit Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane 2024-2029, Bashkia Gramsh, relacionin dhe dokumentat shoqërues të tij, paraqitur nga Kryetari i Bashkisë

Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI:

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a. miratimin e projektaktit

Valbona Verushi  
Kryetaree Komisionit

Brunilda Gjevori  
Sekretaree Komisionit

Brunilda Ballolli  
Anetare Komisioni

Gramsh, date:29.05.2024